



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____ .2015

“PËR
DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9376, DATË
21.04.2005, “PËR SPORTIN”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9376, datë 21.04.2005, “Për Sportin”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimet "Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" dhe "Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" zëvendësohen përkatësisht me emërtimet "ministra përgjegjëse për sportin" dhe "ministri përgjegjës për sportin".

Neni 2

Pas pikës 16 të nenit 3 shtohen pikat 17, 18, 19, 20 dhe 21 me këtë përmbajtje:

“17. “Sportistë të nivelit të lartë” - janë persona që praktikojnë sistematikisht dhe në mënyrë të organizuar sportin, duke marrë pjesë në veprimtari sportive dhe arritur rezultate të larta në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

18. “Terren sportiv” - është çdo mjedis apo sipërfaqe e hapur, në të cilën ushtrohet aktivitet sportiv.

19. “Ambient sportiv” - është çdo ambient ose pjesë e një ndërtese apo hapësirë të mbyllur rreth saj, që shërben për veprimtari sportive.
20. “Instruktor” - është specialist i sportit që jep mësim për të përvetësuar një mjeshteri të caktuar, në drejtimin e një stërvitje sportive .
21. “Trajner” - është profesionisti i përgatitur në fushën e trajnimit sportiv, i cili stërvit një individ apo ekip dhe ta përgatisë atë për garim apo ndeshje.”.

Neni 3

Neni 6 ndryshon si më poshtë:

“Neni 6

Edukimi fizik dhe sporti në sistemin arsimor

1. Sporti është pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike dhe jopublike.
2. Edukimi fizik në arsimin parauniversitar është pjesë e kurrikulës bërthamë dhe kurrikulës me zgjedhje të planit mësimor. Edukimi fizik në kurrikulën bërthamë zhvillohet me minimumin 3 orë mësimore në javë për klasat 1-12. Përjashtimet nga ky rregull përcaktohen nga ministri përgjegjës për arsimin, ndërsa për arsimin profesional parauniversitar nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës i linjës. Në arsimin universitar edukimi fizik përcaktohet në aktet e brendshme të vetë institucioneve të arsimit të lartë.
3. Të gjitha institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore krijojnë kushtet e nevojshme që nxënësit, studentët, efektivat e policisë dhe të Forcave të Armatosura të zhvillojnë veprimtari fizike dhe sportive, individuale dhe/ose të organizuara.
4. Përveç disiplinës mësimore të përfshirë si pjesë të kurrikulës, aktivitetet sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare, jashtë procesit mësimor, organizohen edhe nga shoqatat sportive shkollore dhe shoqatat sportive universitare, të cilat mund të jenë të një sporti ose shumë sportesh, aktiviteti i të cilave koordinohet sipas përkatësisë nga Federata të Sportit Shkollor dhe Sportit Universitar.
5. Shkollat sportive janë institucione arsimore të arsimit të mesëm të lartë me orientim sportiv të të nxënit. Pranimi në shkollat e arsimit të orientuar bëhet sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen me akte ligjore dhe nënligjore.
6. Të gjitha institucionet arsimore para universitare dhe universitare, publike ose jo publike, të zbatojnë standardet në fuqi për zhvillimin e orës mësimore të edukimit fizikë dhe sporteve, për nxënësit dhe studentët.”.

Neni 4

Titulli i kreut III, ndryshon si më poshtë:

“KREU III KËSHILLI KOMBËTAR I EKSPERTEVE TE SPORTIT”

Neni 5

Neni 9 ndryshon si më poshtë:

“Neni 9

Këshilli Kombëtar i Eksperteve të Sportit është organ këshillimor, pranë ministrit përgjegjës për sportin i cili merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin.

Përbërja strukturore dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Kombëtar të Ekspertëve të Sportit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministri përgjegjës për sportin është kryetar i Këshillit Kombëtar të Ekspertëve të Sportit dhe emëron anëtarët e tij, pesë (5) prej të cilëve propozohen nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Ministri përgjegjës për sportin miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Ekspertëve të Sportit .

Neni 6

Neni 11 ndryshon si më poshtë:

“Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

1. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është person juridik, që organizohet dhe funksionon në zbatim të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse” dhe që e ushtron veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpikë dhe statutin e tij të miratuar nga Ministri përgjegjës për sportin, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente.
2. Ndryshimet statusore bëhen nëpërmjet procedurave të përshkruara në legjislacion shqiptar. Ministri përgjegjës për sportin ka detyrimin të miratojë ndryshimet brenda një afati kohor prej 60 ditësh, pas kalimit të këtij afati akti konsiderohet i miratuar në heshtje.

3. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar mund të financohet me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit në formë grandi, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe burime të tjera të ligjshme.
4. Ministria përgjegjëse njih vetëm një Komitet Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e këtij Komiteti.
5. Në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar aderojnë federatat shqiptare, organizata të tjera sportive dhe persona juridik dhe fizik të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij Komiteti.
6. Vendimet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar bëhen publike, nëpërmjet dërgimit zyrtar të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 7

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

Federatat sportive

1. Federata Shqiptare është person juridik që organizohet dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse” dhe që e ushtron veprimtarinë në përputhje me statutin e saj, të miratuar nga Ministri përgjegjës për sportin, në një sport të caktuar përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente.
2. Federatat sportive pas titullit të përkatësisë, duhet të shënojnë emërtimin “Federatë Shqiptare”.
3. Të drejtën për të përfituar emërtimin “Federatë shqiptare” e një sporti të caktuar e gëzon ajo organizatë sportive, e cila krijohet me nismën e personave juridik dhe fizik, organizata dhe klube sportive të atij sporti, që kanë pranuar emërtimin dhe statutin e federatës.
4. Pas miratimit të statutit nga ministri përgjegjës, organet drejtuese të federatës, kanë të drejtën të kërkojnë regjistrimin e federatës përkatëse në gjykatën kompetente.
5. Ministria përgjegjëse njih vetëm një federatë në një sport të caktuar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e kësaj federate.
6. Ndryshimet statusore ose të akteve të formimit të federatave sportive bëhen nëpërmjet procedurave të përshkruara në legjislacion shqiptar. Ministri përgjegjës për sportin ka detyrimin të miratojë ndryshimet brenda një afati kohor prej 60 ditësh në të kundërt, pas kalimit të këtij afati akti konsiderohet i miratuar në heshtje.
7. Federatat shqiptare gëzojnë të drejtën për t’u anëtarësuar në organizata të tjera sportive të nivelit më të lartë, brenda dhe jashtë vendit.

8. Vendimet dhe veprimtaritë sportive të federatave sportive shqiptare bëhen publike nëpërmjet dërgimit zyrtar të gjithë anëtarëve të saj.
9. Personat me aftësi të kufizuar, mund të themelojnë federatën e tyre.

Neni 8

Pikat 2 dhe 3 të nenit 15 ndryshohen, si më poshtë:

“Neni 15

2. Akti i emërimit “Federatë Shqiptare”, të një sporti të caktuar jepet nga ministri përgjegjës për sportin, pas opinionit të marrë nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar paraqet opinionin jo në vonë se 30 ditë nga dita e marrjes së njoftimit.
3. Akti i emërimit “Federatë shqiptare” e një sporti i revokohet një organizate sportive nëse:
 - a) veprimtaria e saj nuk zhvillohet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në statut;
 - b) asambleja e përgjithshme e saj merr vendime antikushtetuese dhe të jashtëligjshme;
 - c) pushon së funksionari, si rezultat i shpërbërjes së saj.”.

Neni 9

Neni 16 ndryshon si më poshtë:

“Neni 16

1. Federatat shqiptare mund të financohen nga shteti dhe nga fondet e dhëna në formë grandi, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit, si dhe nga burime të tjera.
2. Akordimi i fondeve buxhetore, bëhet nëpërmjet udhëzimit të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për sportin dhe Ministrisë së Financave.
3. Ministria përgjegjëse për sportin, në mbështetje të ligjit, mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e grandit të dhënë federatës shqiptare.
4. Federata shqiptare e një sporti të caktuar, krahas detyrave statusore, ka edhe këto detyra:
 - a) të organizojë, drejtojë, kontrollojë dhe vëzhgojë aktivitetet sportive zyrtare në nivel kombëtar, në bazë të rregulloreve të miratuara;
 - b) të organizojë kampionatin kombëtar dhe të shpallë “ekipin Kampion Kombëtar” në sportin përkatës;
 - c) të organizojë Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë “fituesin e Kupës së Shqipërisë” në sportin përkatës;

- c) të marrë masa për parandalimin dhe të luftojë dhunën, si dhe të promovojë sportin e pastër dhe tolerancën;
 - d) të përdorë simbolet e federatës ose të autorizojë përdorimin e tyre nga anëtarë të tjerë, për çdo qëllim;
 - e) të organizojë ekipin kombëtar dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari;
 - f) të organizojë aktivitete zyrtare me karakter ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin.
5. Asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.”.

Neni 10

Neni 19 ndryshon si më poshtë:

“Neni 19

Klubet sportive

1. Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë, sipas legjislacionit në fuqi “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe “Për organizatat jofitimprurëse”.
2. Institucionet shtetërorë kanë të drejtë të krijojnë klube sportive të një ose shumë sporteve, të cilat kanë personalitet juridik dhe organizohen e funksionojnë në bazë të aktit themelues të organit krijues.
3. Procedurat e transformimit të klubeve realizohen me vendim të organit krijues brenda një periudhe kohore prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 11

Neni 22 ndryshon, si më poshtë:

“Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo anëtar i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, ka të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjet, përpara Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Të drejtat, detyrat dhe mënyra e emërimit të anëtarëve të KAS-it , funksioni dhe kompetencat për të cilat ai shprehet dhe merr vendim, përcaktohen në rregulloren e tij, e cila miratohet në Asamblenë e Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar me shumicë të cilësuar të anëtarëve.

KAS funksionon mbi bazën e Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Proceduarve Civile.

Vendimet e KAS mund të ankimohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit, vetëm për mosrespektim të procedurave të ndjekura nga KAS.

Neni 12

Neni 26 ndryshon si më poshtë:

“Neni 26

Sporti dhe statusi i sportistit të nivelit të lartë

1. Sporti i nivelit të lartë është një faktor vendimtar për zhvillimin e sportit në planin kombëtar, si dhe luan një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e Shqipërisë në veprimtari sportive ndërkombëtare.
2. Njësitë e qeverisjes qëndore dhe njësitë e qeverisjes vendore, sigurojnë dhe mbështesin trajtimin, shpërblimin dhe integrimin në sistemin arsimor, social dhe profesional të sportistëve të nivelit të lartë, të cilët kanë arritur rezultatet “rekord olimpik”, “rekord botëror”, “rekord evropian”, “vendi i parë deri në të tetin në Lojrat Olimpike”, “vendi i parë deri në të pestin në kampionate botërore” dhe “vendi i parë deri në të tretin në kampionate evropiane”, “vendi i parë në Lojërat Mesdhetare” në aktivitetet ndërkombëtare zyrtare.
3. Mënyra e shpërblimit të sportistëve që arrijnë kriteret e statusit të sportistit të nivelit të lartë, si dhe përfitimi i trajtimit për përgatitjen sportive, përcaktohen me vendim të Keshillit të Ministrave.
4. Institucionet arsimore publike me drejtim sportiv, siguri kombëtare dhe mbrojtje, sigurojnë kryerjen e studimeve për sportistët, të cilët plotësojnë kriteret e përfitimit të statusit të sportistit të nivelit të lartë, pa konkurs dhe sipas një plani individual.”.

Neni 13

Në Kreun VIII, pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 31/1

1. Destinacioni i objekteve sportive, nuk mund të ndryshojë, pavarësisht pronësisë apo subjektit administrues.
2. Objektet sportive jepen me koncesion apo privatizohen, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni.”.

Neni 14

Neni 37 ndryshon si më poshtë:

“Neni 37

Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit

Pranë ministrisë përgjegjëse për sportin krijohet Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit nga të ardhurat, që sigurohen nga lotaritë sportive, sipas kuadrit ligjor në fuqi për lojërat e fatit. Përdorimi i Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin, sipas udhëzimit të nxjerrë prej tij në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 15

Neni 46 shfuqizohet.

Neni 16

Pika 2 e nenit 48, ndryshon si më poshtë:

“2. Personi që merr pjesë në veprimtaritë sportive në cilësinë zyrtare (gjyqtari, vëzhguesi, etj.) është i paprekshëm”.

Neni 17

Pika 1 e nenit 49 ndryshon si më poshtë:

“Neni 49

1. Organizatori i një veprimtarie sportive është i detyruar që për këtë veprimtari të njoftojë policinë 10 ditë përpara zhvillimit të saj. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjedise sportive, është detyrë institucionale e organeve të Policisë së Shtetit.”.

Neni 18

Pika 1 e nenit 50, ndryshon si më poshtë:

“Neni 50

1. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës është një strukturë me karakter këshillimor, pranë ministrisë përgjegjëse për sportin. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport, inicion dhe harton politika për parandalimin e dhunës gjatë aktiviteteve dhe shfaqjeve sportive. Përbërja e funksionimi i këtij Komisioni dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pika 2 e nenit 50 shfuqizohet.

Neni 19

Pas nenit 51/1 shtohet neni 51/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 51/2

Dënohet me gjobë, në shumën nga 100 000 deri në 500 000 lekë, organizatat sportive, si dhe anëtarët e tyre në rast se:

- a. Kryejnë veprimtari sportive pa marrë më parë pëlqimin nga organi përgjegjës, në të cilin janë të anëtarësuar.
- b. Organizojnë ose bëjnë propagandë politike e fetare.

Gjobat vendosen nga Komisionet e Disiplinës së organizatave sportive dhe derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit. Dënimi me gjobë mund të shoqërohet edhe me masa të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë sportive për një periudhë kohore nga 6 muaj deri në një vit. Masat shoqëruese jepen nga komisionet disiplinore të federatave përkatëse.”

Neni 20

Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministria përgjegjëse për sportin përgatit dhe propozon në Këshillin e Ministrave gjitha aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E T A R I

ILIR META